



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

(Specialist)

Lloji i diplomës “ INXHINERI NDERTIMI/ELEKTRIKE/ARKITEKTURE etj”
Niveli minimal i diplomës “DIPLOME E NIVELIT TE PARE”

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhetë Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Roskovec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- ❖ 1(nje) Specialist Inxhinier ndretimi/Elektrik,/Arkitekt per Prokurimet

Shpallja eshte e hapur per te gjitha nepunesit civil te se njejtës kategori ne te gjitha institucionet pjese e shërbimit civil. Nese nuk ka nje fitues nga procedura e levizjes paralele, plotesimi i vendit vakant do te realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Pranimin në Shërbimin Civil në kategorine ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

LEVIZJE PARALELE: 19.07.2018

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 24.07.2018

Përshkrim i Përgjithshëm

Specialisti përgjigjet para Përgjegjësit të Sektorit të ceshtjeve të Prokurimeve për menaxhimin e çështjeve që lidhen me fushën e veprimtarisë së sektorit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi.

DETYRAT

Detyrat Kryesore

Eshte nepunes civile ne varesi te Pergjegjesit te Sektorit Juridik dhe Prokurimeve dhe ka keto detyra

- Përbush të gjitha detyrat që i ngarkohen nga Drejtori, në zbatim të legjislacioni në fuqi.
- Relaton pranë Përgjegjësit të Sektorit në mënyrë periodike mbi përbushjen e detyrave të caktuara.
- Mban kontakte të rregullta me anëtarët e komisionit të propozuar nga Kryetari i Entit Prokurues dhe i vë në dijeni për datën, vendin dhe oren në të cilën do të mbledhet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.
- Harton dokumentacionin e tenderit së bashku me komisionin përkatës, për zbatimin e procedurave të prokurimit sipas kërkesave të parashikuara në ligj.
- Mban dhe kontrollon në çdo kohë projektet dhe preventivat që kanë të bëjnë me prokurime të infrastrukturës, ndertimeve, shërbimeve dhe blerjeve.
- Mban të azhurnuar listë shoqërisht të specializuara në projekte të infrastrukturës për procedura të ndryshme prokurimi, në mbështetje të legjislacionit përkatës.
- Mban të azhurnuar listë teknikësh, supervizorësh, dhe studiosh projektimi të specializuar në infrastrukturë.
- Mban të azhurnuar listën e çmimeve mbi zëra të preventivave duke bashkëpunuar me organe të specializuara për projektet e infrastrukturës.
- Vë në dispozicion të kandidatëve dokumentat e tenderit të miratuara nga Komisioni brenda afateve të parashikuara në Ligj.
- Sqaron kandidatët që kanë tërhequr dokumentacionin për tender mbi çdo paqartësi që mund të kenë gjatë hartimit të ofertave në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Enti Prokurues.
- I komunikon kandidatëve që kanë tërhequr dokumentacionin brenda afatit të parashikuara në ligj çdo ndryshim në dokumentat e tenderit, të miratuara nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.
- Ka për detyrë të ruajë fshehtësinë e shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender deri në momentin e komunikimit zyrtar të fituesit nga Kryetari i Entit Prokurues dhe nënshkrimit të kontratës
- Mban përgjegjësi për respektimin e afateve kohore të procedurave të prokurimit, njoftimin në buletin, specifikimet teknike, sigurimin e materialeve për plotësimin e dokumentave të tenderit, përgatitjen e

dokumentave të tenderit në bazë të formularëve përkatës të parashikuar në ligj

- Mban procesverbalet e mbledhjeve të komisionit duke pasqyruar me transparencë çdo vendim të marrë në mbledhjet përkatëse.
- Mban përgjegjësi për firmosjen e procesverbaleve nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave si dhe Njësisë së Prokurimit Plotëson dosjet përkatëse të procedurave të prokurimit duke organizuar në të gjithë dokumentacionin e tenderit (urdhër prokurimi, njoftime, vendime të komisionit etj)
- Me lidhjen e kontratës, bën dorëzimet e dosjeve me procesverbal pranë drejtorive përkatëse.
- Bën inventarin e dosjes së procedurave të prokurimit dhe kujdeset për dorëzimin e tyre në arkivin e Bashkisë Roskovec në mënyrë dhe brenda afatit të parashikuar në ligj.

I Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këto pozicion janë:

- a te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degët e Inxhinierise se Ndertimit, Arkitektures. Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b te kete te pakten 1 vit punë.
- c Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorise Juridike dhe te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovecs, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.

- Fotokopje e vleresimit të fundit vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **19.07.2018**

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së levizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **23.07.2018** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin "Sherbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësine e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, brenda 3 ditëve kalendrike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendrike nga data e paraqitjes së saj.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë Roskovec **me datë**

27.07.2018 ora 11:00

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen Vendore"
- Ligji 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar nga ligji nr. nr. 73/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar nga ligji nr. ligjin Nr. 9200, datë 26.02.2004, ligji nr. 9794, datë 23.07.2007, ligji nr. 9826, datë 01.11.2007, ligji nr. 10 137, datë 11.05.2009, ligji nr. 10 324 datë 23.09.2010, ligji nr. 11/2012 datë 09.02.2012 dhe ligji nr. 20/2013 datë 14.2.2013;
- Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligji nr. 23/2013 datë 14.2.2013 dhe ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i**

Brendshëm për Lëvizjen Paralele i ngritur në Bashkinë Roskovec, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv.

b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 dt.18.03.2015 ‘Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese’

Komisioni në date **30.07.2018** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njërëzore.

Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njërëzore me date **31.07.2018** shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkise dhe ne stenden e publikimeve te Bashkisë Roskovec.

II- Pranimi në Shërbimin Civil.

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë e kzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotrojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar(hequr) sipas këtij ligji.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- a) te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degët e , Inxhinierise Ndertimit, Arkitektures. Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) te kete te pakten 1 vit punë.
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovec këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës e pranimit në shërbimin civil dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **30.07.2018** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njërëzore për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njërëzore, Informacionit dhe Marrdhënieve me Publikun, brenda 5 diteve kalendarike nga dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve pune nga data e depozitimit të saj.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë Roskovec në datën **06.08.2018 ora 10:00**

Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me gojë, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen Vendore"
- Ligji 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar nga ligji nr. nr. 73/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar nga ligji nr. ligjin Nr. 9200, datë 26.02.2004,
- ligji nr. 9794, datë 23.07.2007, ligji nr. 9826, datë 01.11.2007, ligji nr. 10 137, datë 11.05.2009, ligji nr. 10 324 datë 23.09.2010,
- ligji nr. 11/2012 datë 09.02.2012 dhe ligji nr. 20/2013 datë 14.2.2013;
- Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligji nr. 23/2013 datë 14.2.2013 dhe ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 20 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimi, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "Specialist Inxhinier per Prokurimet”

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimi brënda 24 (njëzet e katër) orëve, pra në date. **07.08.2018** njofton listen e fituesve, Njesise pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerëzore.

Njesia pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore më **date 13.08.2018** , shpall listen e fituesve.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” , në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe ne stenden e informimit publik.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne adresen Bashkia Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : evisa.mustafaj@yahoo.com

nr.tel: **0387 80242.**

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA ROSKOVEC